

PRIORITETET URGJENTE TË REFORMAVE

Statusi

Legjenda

- 4 - Masat e zbatuara nuk janë në drejtim të përmbushjes së prioritetit
- 3 - Nuk zbatohet ose masat e zbatuara janë në kundërshtim me prioritetin
- 2 - Në rrjedhë e sipër
- 1 - Është realizuar

1. Sundimi i së drejtës dhe jurisprudenca

A. Jurisprudenca

Depolitizimi i emërimit dhe avancimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, jo vetëm teorikisht por edhe në praktikë, në bazë të kriterëve transparente dhe objektive, të bazuara në mënyrë rigorozë sipas meritës, të zbatuara me procedurë transparente dhe të hapur. 3

○ Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli i prokurorëve publik vazhdoi të zgjedh gjyqtarë pa bërë ndryshime esenciale në mënyrën e zgjedhjes. Me transferimin e përkohshëm të gjyqtarëve nga gjykatat themelore të shtetit në Gjykatën Themelore Shkup 1 dhe transferimin e përkohshëm për ushtrimin e funksionit të gjyqtarit të shtatë gjyqtarëve nga gjykatat e apelit nga brendia e shtetit në Gjykatën e Apelit Shkup, Këshilli Gjyqësor kishte ndikim të drejtpërdrejtë mbi strukturën e gjyqtarëve të cilët vendosnin për lëndët me profil të lartë të cilat i ngriti Prokuroria Publike. Përveç kësaj zgjedhja e ushtruesit të detyrës të Gjykatës Themelore Shkup 1 dhe kryetarit të Gjykatës Supreme nga Këshilli Gjyqësor pasoi kritika nga mediat dhe ekspertët, dhe nga shoqëria e gjyqësorit. Me praktikën e këtilla, janë vënë në pikëpyetje parimet themelore të veprimit të Këshillit si institucion i pavarur.

Instalimi i sistemit të harmonizuar për performansa, i bazuar mbi standardet kualitative dhe kuantitative, si bazë për të gjitha vendimet për karrierë. 3

○ Nuk janë ndërmarrë hapa për vendosjen e sistemit të harmonizuar në lidhje me administrimin e efikasitetit të punës që do t'i ketë parasysh edhe kriteret kualitative. Këshilli Gjyqësor e vazhdoi praktikën e miratimit të vendimeve për përcaktimin e numrit të përafërt të lëndëve të cilat duhet t'i zgjidh gjyqtari në nivel mujor në të gjitha gjykatat. Si njëri nga kriteret kryesore të efikasitetit në punë.

3

Të shmangen ato elemente të sistemit për procedura disiplinore dhe shkarkimin e gjyqtarëve të cilët momentalisht e çrregullojnë pavarësinë e gjyqësorit edhe në legjislacion edhe në praktikë.

○ Përkundrejt reagimeve të sektorit civil, si dhe opinionit të Komisionit të Venecias për jo përshtatshmërinë e Këshillit për Përcaktimin e Fakteve dhe Ngritjen e Procedurës për Përcaktimin e Përgjegjësisë së Gjyqtarit, me procedurë të shpejtë u miratua ligj dhe u formua Këshilli për Përcaktimin e Fakteve dhe Ngritjen e Procedurës për Përgjegjësinë e Gjyqtarit.

3

Të sigurohet profesionalizmi i Këshillit Gjyqësor, në praktikë dhe jo vetëm teorikisht (përkatësisht testim i qartë dhe i parashikueshëm për zbatimin e obligimit statutor të "jurist i shquar").

○ Nuk janë bërë ndryshime as praktike dhe as ligjore në këtë drejtim.

2

Të rritet roli proaktiv i Këshillit Gjyqësor dhe i gjykatave më të larta, në mënyrë që gjyqtarët të mbrohen nga ndërhyrja në pavarësinë e tyre (përmes strategjive të përmirësuara të komunikimit dhe përmes aktivitetit pa ekuivoqe në bazë të ankesave për ndërhyrje ose presion).

○ Këshilli Gjyqësor nuk e vendosi praktikën e mbrojtjes së pavarësisë së gjyqtarëve dhe integritetit të tyre. Gjykata Supreme si gjykatë më e lartë në shtet në mënyrë plotësuese e rrezikon pavarësinë e gjyqësorit. Dosja e vendimeve të miratuara sipas kundërshtimeve ndaj gjyqtarëve (veçanërisht rasti i Gjykatës Themelore Shkup 1 dhe kundërshtimi për rialokim të kryetares së mëhershme të Gjykatës së Lartë), vë në dukje praktika të kundërta. Përpjekjet siç është Manuali i miratuar i Këshillit Gjyqësor për komunikimin e gjykatave me publikun nuk rezultoi me komunikim të avancuar me qytetarët dhe sektorin civil.

2

Të përmirësohet cilësia e edukimit, buxhetit dhe autonomisë së Akademisë së Gjyqtarëve dhe Prokurorëve (dhe të inkurajohet dërgimi i gjyqtarëve nacional për të fituar përvojë pune në GJEDNJ)

○ Akademia e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë inkorporoi risi në kurrikulën, ka buxhet të rritur dhe progres në zbatimin e trajnimeve. Megjithatë, roli i Akademisë në zgjedhjen e kandidatëve të rinj për gjyqtarë dhe prokurorë publikë u problematizua. Këtë e inicioi fillimi i vonuar i trajnimit fillestar të gjeneratës së 6-të të dëgjuesve në Akademinë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë, sipas procedurave të zbatuara ndaj ankesave dhe aktgjykimeve të Gjykatës Administrative, si dhe rasti i zgjedhjes së prokurorëve publikë me indicie për diploma të falsifikuara për njohjen e gjuhës së huaj.

2

Të sigurohet publikimi i të gjitha aktgjykimeve gjyqësore në afate të qarta, të përcaktuara me ligj (dhe të sigurohen mundësi gjithëpërfshirëse për kërkimin dhe qasjen e lehtë)

○ Nuk ka të dhëna për vonesën e publikimit të aktgjykimeve nga ana e gjyqtarëve. Me krijimin e portalit të ri gjyqësor www.sud.mk janë bërë përpjekje në drejtim të rritjes së transparencës së gjyqësorit, por funksionaliteti i deritanishëm i portalit nuk ka treguar progres, në krahasim me sistemin e kaluar të publikimit të aktgjykimeve, nga çdo gjykatë veç e veç.

2

Të përpilohet dosje për kohëzgjatjen e përgjithshme të procedurave gjyqësore me fokus special mbi "rastet e parashkruara"

○ Nuk kemi të dhëna për realizimin e Plan Veprimit të Këshillit Gjyqësor të miratuar më 12 janar të vitit 2016 për zgjidhje intervente të lëndëve të pazgjidhura më të vjetra se 7 dhe 10 vjet në RM.

2

Të sigurohet zbatim i shpejtë i të gjitha aktgjykimeve të GJEDNJ kundër shtetit (veçanërisht përmes zhvillimit të masave praktike dhe efektive për çdo kategori të rasteve)

○ Ekzekutimi i aktgjykimeve të GJEDNJ është efikas vetëm në pjesën e ngarkimeve monetare. Për lëndët e tjera bëhen përpjekje përmes përpilimit të plan veprimeve për ekzekutimin e lëndëve të veçanta, ndërsa më vonë parashtrihen edhe raporte. Byroja për Përfaqësimin e Republikës së Maqedonisë para Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut e vuri në funksion ueb-faqen e re <http://biroescp.gov.mk>, e cila i përmban të gjitha informacionet relevante në lidhje me kompetencat e Byrosë, si dhe të gjitha informacionet për punën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

B. Monitorimi funksional gjyqësor dhe parlamentar mbi ndjekjen e komunikimeve

3

Të sigurohet ndarje më e qartë e mandateve dhe akteve normative, të cilat kanë të bëjnë me ndjekjen e komunikimeve, nga njëra anë - për hetime penale, ndërsa nga ana tjetër - për qëllime të sigurisë.

Nuk janë ndërmarrë aktivitete për realizimin e këtij prioriteti.

3

Të evitohet funksioni ndërmjetësues i DSK si "gardian" i aktiviteteve të ndjekjes nga ana e organeve me autorizime të posaçme (policia, dogana, policia nanciare)

Nuk janë ndërmarrë aktivitete për realizimin e këtij prioriteti.

3

Të evitohet qasja e drejtpërdrejtë e DSK në pajisjen teknike, e cila mundëson ndjekjen e sinjalit të komunikimit të operatorëve të telekomunikacionit (për shembull, shmangia e plotë e aftësisë praktike dhe teknike e DSK për përfshirjen e).

Nuk janë ndërmarrë aktivitete për realizimin e këtij prioriteti.

3

Të sqarohet në ligj dhe në praktikë që operatorët e telekomunikeve të guxojnë ta aktivizojnë dhe riorientojnë sinjale ndaj agjencive kompetente për zbatimin e ligjit (policia, dogana, policia nanciare), ose agjencitë e sigurisë (DSK, Agjencia e Zbulimit dhe Shërbimi Ushtarak për Siguri dhe Zbulim pranë Ministrisë së Mbrojtjes) vetëm me pranimin paraprak të urdhrat relevant gjyqësor dhe vetëm për ndjekje ligjore.

Nuk janë krijuar kushte elementare për përmbushjen e këtij prioriteti.

3

Të instalohen mekanizma për menaxhimin me kriza për orientim dhe udhëheqje të të gjitha operacioneve të zbulimit, si dhe për sigurimin e përforcuar dhe arkivimin e të dhënave.

Nuk janë krijuar kushte elementare për përmbushjen e këtij prioriteti.

3

Të sigurohet trajnim adekuat i të punësuarve për mbrojtjen e të dhënave, të drejtave themelore, etikës profesionale dhe integritetit.

○ Nuk janë krijuar kushte elementare për përmbushjen e këtij prioriteti.

4

Të sigurohet mbledhje urgjente dhe e rregullt e komisioneve përkatëse parlamentare për ndjekjen e komunikimeve dhe për siguri dhe kundërzbulim, si dhe funksionimi papengësë i tyre.

○ Komisionet parlamentare në përbërjen e re parlamentare akoma nuk janë formuar.

3

Të sigurohet që këto komisione të funksionojnë në përputhje me detyrat e tyre ligjore për njoftim, si dhe t'u mundësohet papengësë t'i pranojnë të dhënat e nevojshme, dëshmitë, ndihmën teknike dhe qasjen, të domosdoshme për përgatitjen e.

○ Komisionet parlamentare në përbërjen e re parlamentare akoma nuk janë formuar.

C. Organe të pavarura rregullatore, kontrolluese dhe mbikëqyrëse

3

Të sigurohet autonomi e kënaqshme e organeve të pavarura rregullatore, kontrolluese dhe mbikëqyrëse, jo vetëm në aspekt teorik por edhe në atë praktik, në mënyrë që të njëjtat të veprojnë në mënyrë efektive dhe pa presion politik. Për këtë nevojiten jo vetëm angazhime proaktive të vet organeve, por edhe vullnet politik i të gjithë faktorëve të tjerë në mënyrë që t'u lejojnë t'i kryejnë funksionet e tyre siç është parashikuar me ligj, përfshirë këtu edhe akordimin e mjeteve të mjaftueshme financiare.

○ Nuk ka progres në këtë drejtim. Organet e pavarura në masë të madhe janë nën ndikim të drejtpërdrejtë të pushtetit të kaluar.

3

Të sigurohet se anëtarësia në organet e pavarura rregullatore mbështetet mbi aftësitë profesionale, përvojën profesionale përkatëse për fushën dhe përparësinë komparative gjatë zgjedhjes/emërimit.

○ Nuk ka progres në këtë drejtim. Organet e pavarura në masë të madhe janë nën ndikim të drejtpërdrejtë të pushtetit të kaluar.

3

Të sigurohet se rekomandimet e Zyrës së Avokatit të Popullit dhe të organeve të tjera këshillëdhënëse respektohen nga ana e të gjitha organeve shtetërore përmes respektimit të plotë të ligjit dhe parimit të llogaridhënies.

○ Në Raportin e Avokatit të Popullit për vitin 2016 është konstatuar stagnim, ndërsa në disa fusha edhe kthim pas, që konfirmohet edhe me numrin e rritur të cenimeve të konstatuara ndaj lirive dhe të drejtave të njeriut, për katër për qind.

Mes tjerash vihet në dukje ekzistimi i institucioneve skajshëm të politizuara dhe jofunksionale, të cilat zbatonin edhe agjenda partiake, veprim joprofesional dhe brutal policor, përdorim tejmase të forcës nga ana e policisë së burgjeve ndaj personave të dënuar dhe mungesa e mbrojtjes sistematike shëndetësore në institucionet ndëshkuese-korrektuese, mangësi në sistemin pensional me pasoja të dëmshme ndaj të siguruarve, mjete të pasiguruara për të drejtat e mbrojtjes sociale, cenimi i të drejtës së punësimit të personave me aftësi të kufizuara, deportimi i paligjshëm i refugjatëve, përcaktimi kundërligjor dhe arkëtimi i taksës radiodifuzive dhe ujit, tatimimi i kundërligjshëm i qytetarëve, si dhe joprofesionalizëm në punën e organeve zgjedhore.

3

Të sigurohen sanksione efikase ligjore për mospërbushjen e kërkesave dhe rekomandimeve të organeve të pavarura.

○ Në Raportin e Avokatit të Popullit për vitin 2016 theksohet se ka institucione të cilat nuk e kuptojnë rolin e Avokatit të Popullit, kështu që edhe përkrah obligimit ligjor ata thjeshtë nuk bashkëpunojnë, ndërsa disa në mënyrë të vrazhdë e pengojnë punën. Për shkak të pengimit të punës nga ana e Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale, Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Drejtësisë, Prokurorisë Publike, Drejtorisë së të Ardhurave Publike dhe NP "Ujësjiellës dhe Kanalizim"- Shkup, Avokati i Popullit nuk pati sukses të zbatoj procedurë të plota për mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve.

4

Të sigurohet se Zyra e Avokatit të Popullit është rregulluar plotësisht në përputhje me Parimet e Parisit.

○ Nga muaji mars i vitit 2017, filluan të zbatohen ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për Avokatin e Popullit, të miratuara në vjeshtën e vitit 2016, me ç'rast u bë harmonizimi në përputhje me këtë prioritet. Në këtë mënyrë, në aspektin normativ u krijuan parakushte për fitimin e Statusit A të Institucionit Nacional për të Drejtat e Njeriut. Megjithatë, nuk ka informacione të aksesshme nëse të njëjtat u realizuan në praktikë.

Ç. Politikat kundër korrupsionit dhe legjislacioni

3

Të inkorporohet dojse autentike për korrupsionin e nivelit të lartë, ashtu që organet të cilat e zbatojnë ligjin dhe organet mbikëqyrëse të kenë autonomi të mjaftueshme që të veprojnë të pavarura, në përputhje me ligjin (autenticiteti i dosjeve aktuale është çrregulluar për shkak të mungesës së një numri të caktuar të lëndëve të prolit të lartë nga vitet paraprak).

○ Veprimi i Prokurorisë Speciale Publike është një hap përpara në këtë drejtim. Megjithatë, obstrukcioni i deritanishëm nga institucionet dhe praktika e gjykatave në lidhje me propozimet e PSP e vuri në dukje ndikimin serioz të pushtetit të kaluar në drejtim të pengimit të zbatimit të drejtësisë.

2

Duhet të përforcohet lufta e përgjithshme kundër korrupsionit.

○ Organet shtetërore kompetente për parandalimin dhe pengimin e korrupsionit, praktikisht e mbronin korrupsionin e lartë, me përjashtim të Prokurorisë Speciale Publike. Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit nuk e realizon funksionin e tij. Sipas një hulumtimi të Institutit për Politikë Evropiane dhe të Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në kuadër të Projektit "Rrjeti 23 +" 60 % e të anketuarve janë të mendimit se lufta kundër korrupsionit është në nivel të ulët, ndërsa 47 % prej tyre gjenden në jurisprudencë e vlerësojnë si të keqe.

4

Të përmirësohet kontrolli i deklaratave për kon-ikt të interesit dhe listave anketuese të funksionarëve të zgjedhur dhe të emëruar, përmes instalimit të Regjistrisë qendror të personave të këtyllë.

○ Nuk janë publikuar fletë-deklarimet e anëtarëve të KSHPK, ndërsa shumë raste të ngritura në publik nuk janë proceduar (rasti i pesë drejtorëve të institucioneve nacionale dhe kulturore dhe të institucioneve të cilat nuk kanë paraqitur fletë-deklarime për gjendjen e tyre pronësore, edhe pse një periudhë të gjatë janë persona udhëheqës). Në periudhën e ardhshme aktualizohet publikimi i fletë-deklarimeve të funksionarëve të sapo zgjedhur dhe të emëruar.

2

Të punohet me ekspertë të GREKO në mënyrë që të instalohet një mekanizëm i ri gjithëpërfshirës për mbrojtjen e denoncuesve në përputhje me rekomandimet e fundit të Këshillit të Evropës dhe praktikat më të mira evropiane.

○ Ligji i miratuar për mbrojtjen e denoncuesve nga muaji nëntor i vitit 2015 në praktikë nuk zbatohet realisht. Përveç kësaj, nuk janë ndërmarrë hapa që të merret parasysh opinioni i Komisionit të Venecias. IHSE, në hulumtimin e tij të zbatuar në kuadër të Projektit “Rrjeti 23+”, propozoi rekomandime për ndryshimin e Ligjit për mbrojtjen e denoncuesve konform rekomandimeve të Komisionit të Venecias në pjesën e mekanizmave për avancimin e implementimit të ligjit. Denoncuesit e krimit dhe korrupsionit (whistleblowers) nuk janë të popullarizuar, përkatësisht nuk e kanë mbështetjen as të qytetarëve të vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe më së paku të Maqedonisë, vë në dukje hulumtimi i zbatuar në shtatë vende, mbi 7.000 të anketuar, me mbështetje të Këshillit Rajonal për Bashkëpunim (KRB) me seli në Sarajevë.

D. Lustracioni

4

Të adresohen mangësitë serioze dhe të revidohet/tërhiqet Ligji për lustrim dhe zbatimi i tij (veçanërisht duke e pasur parasysh amicus curiae mendimin e Komisionit të Venecias) lidhur me kufizimet kohore, mbrojtjen nga motivet politike, ideologjike ose partiake të cilat shfrytëzohen si baza për lustrim; përjashtimi i personave në pozita private ose gjysmë-private dhe mbrojtja më e fuqishme e identitetit të subjektit deri në vendimin përfundimtar gjyqësor).

○ Shfuqizimi i Ligjit dhe Komisionit nuk i zgjidhi pasojat e jashtëzakonshme negative nga veprimi i tyre. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut miratoi më shumë aktgjykime kundër Republikës së Maqedonisë në lëndët e lustracionit.

2. Depolitizimi i administratës publike

3

Në mënyrë strikte të zbatohet korniza e re ligjore, Ligji për nëpunësit administrativ dhe Ligji për të punësuarit në sektorin publik, përmes respektimit të plotë të parimeve të transparencës, meritës dhe përfaqësimit të drejtë.

○ Kundrejt kornizës formale, në praktikë vazhdoi partizimi i administratës publike.

3

Politikat e punësimit duhet t'i ndjekin parimet e transparencës, meritës dhe përfaqësimit të drejtë në shërbimin publik, përmes procedurave të transparente. Nuk duhet të ketë punësime të mëtutjeshme pa i respektuar rregullat.

○ Kundrejt kornizës formale, në praktikë vazhdoi partizimi i administratës publike.

3

Ligji për transformimin e punësimeve të përkohshme në pozicione të përhershme të vendoset në moratorium, kështu derisa parimi i meritës të respektohet tërësisht në procesin e transformimit.

○ Veprohej në kundërshtim me prioritetin.

2

Të prezantohen numrat për të gjithë nëpunësit e punësuar publikë në të gjitha ministritë qeveritare, agjencitë dhe organe të tjera, të ndara sipas sektorëve.

○ Sipas Raportit të publikuar, të dytë vjetor, gjatë muajit të kaluar mars në sektorin publik të Republikës së Maqedonisë aktive janë 1.291 institucione, në të cilat marrëdhënie pune kanë lidhur 129.653 persona.

3. Reforma zgjedhore

2

Të kryhet reforma zgjedhore në përputhje me rekomandimet të OBSE/ODIHR dhe të Komisionit të Venedikut, duke kështu dhe zmadhimin e proporcionit dhe mundësive të paraqiten ankesa dhe parashtrësia, duke siguruar ndarje të mjaftueshme midis aktiviteteve të shtetit dhe partive politike dhe sigurimit të qasjes dypartiake të organeve zgjedhore në të gjitha nivelet.

○ Sipas Raportit përfundimtar të OSBE/ODIHR, lidhur me zgjedhjet e parakohshme parlamentare nga 11 dhjetori i vitit 2016, nevojitet që edhe më tutje të punohet në avancimin e kornizës ligjore. Gjithashtu, rekomandohet që autoritetet dhe partitë politike të ndërmarrin hapa konkret në mënyrë që të ushtrohet presion mbi të punësuarit në administratën publike, mbi aktivitetet politike dhe mbi të tjerët që i vizitojnë ngjarjet e këtilla ose gjatë vetë aktit të votimit, ndërsa të dhënat për presion duhet të hulumtohen rrënjësisht. Mes tjerash theksohet edhe se periudha pas-zgjedhore u karakterizua me atmosferë të tensionuar dhe me retorikë të ashpër. Edhe PSP edhe PTHP ndërmorën aktivitete të caktuara para-hetimore për abuzimin e mjeteve financiare në fushatën zgjedhore.

2

Të bëhet rishikimi i Listës zgjedhore në përputhej me rekomandimet e OBSE/ODIHR të vlerësohet saktësia dhe kompletimin e të dhënave të votuesve, veçanërisht në lidhje me votuesit e dyfishtë; votues të regjistruar veçanërisht me të dhëna nga letërnjoftimi dhe të dhëna nga pasaporta; adresa me numër të madh të votuesve të regjistruar. Të identifikohen lëmi për përmirësim të mundshëm në saktësinë e votuesve. Të rishikohet dhe përshtatshëm të përmirësohet saktësia e Listës zgjedhore.

○ Misioni i OSBE/ODIHR rekomandon se nevojitet të rishikohet Kodi Zgjedhor, të rritet transparenca dhe efikasiteti i KSHZ, të bëhet kontroll i rregullt i listave të zgjedhësve, të intervenohet shpejt në rastet kur personat nuk janë në Listën e zgjedhësve.

4. Zbatimi i rekomandimeve të Komisionit Anketues për Ngjarjet e 24 Dhjetorit

3

Të zbatohen rekomandimet e Komisionit Anketues nga viti 2013 në lidhje me funksionimin më të mirë të Kuvendit dhe shpërndarjes së punës së tij.

○ Ndërhyrja në Kuvend në datën 27.04.2017 dhe sulmet fizike mbi deputetët e shumicës së sapoformuar, që mund të kualifikohen edhe si tentativë për vrasje, tregoi se jo vetëm që nuk janë respektuar të dhënat dhe rekomandimet e Komisionit Anketues, por edhe se sigurimi në Kuvend ka qenë nën kontroll të plotë partiak të ish-partisë në pushtet.

5. Mediat: Liria e shprehjes

A. Servisi Publik Radiodifuziv

4

Të sigurohen prova evidente për reformat rrjedhëse në Servisin Publik Radiodifuziv lidhur me politikën, organizimin, edukimin dhe redaktimin të orientuara në drejtim të adresimit të kritikave rregullisht të manifestuara në të kaluarën sa i përket mangësisë së pavarësisë politike, mangësisë së raportimit të balancuar, si dhe sigurimit të përmbajtjeve informative me cilësi të lartë.

○ Pushteti i mëparshëm nuk zbatoi reforma në RTVM të fokusuar mbi pavarësinë; kundrejt kësaj – ishte nën ndikim të drejtpërdrejtë të pushtetit dhe sipas raporteve të pavarura raportonte në mënyrë arbitrare.

B. Reklamimi i Qeverisë

4

Të krijohen rregulla të rrepta për reklamimin e qeverisë të themeluara në kritere transparente, objektive dhe jodiskriminuese.

○ Qeveria e re paralajmëroi se do ta ndërpres këtë praktikë. Megjithatë, duhet të shihet financimi i mediave private me mjete buxhetore në periudhën e kaluar.

3

Të sigurohet transparencë e tërë e reklamimit të qeverisë (jo vetëm në aspekt të shpenzimit të finansave publike por dhe në aspektin e të spektatorëve dhe përmbajtjeve).

○ Deri më tani nuk është siguruar. Qeveria e re paralajmëroi ndërprerje të kësaj praktike. Megjithatë, mbetet të hulumtohet funksionimi i mediave private nga mjetet buxhetore të periudhës së kaluar.

4

Të zhvillohet mekanizëm i shpalljeve të papaguara të servisit publik të cilat janë me të vërtetë me interes publik.

○ Deri më tani nuk është implementuar. Qeveria e re paralajmëroi ndërprerje të kësaj praktike. Megjithatë, mbetet të hulumtohet funksionimi i mediave private nga mjetet buxhetore të periudhës së kaluar.

C. Qasja deri te informacionet

3

Për të adresuar penqesat kryesore me të cilat ballafaqohen gazetarët qiatë maries të informatave publike (p.sh. mosuksesi i organeve relevante që të përqijien në shumë kërkesa për informacion, përdorimi i tepërt i paarsveshëm i kategorisë "konfidencial" për dokumente që nuk janë me natyrë të këitillë).

○ Nuk është realizuar.

Ç. Shpifja

3

Rishikimi i legjislacionit që të largohen rastet e tipit "i shpeshtë", "dinjitet" dhe "fyerje", të cilat fillojnë një definicion nënligjor për fyerje dhe bien jashtë kornizave të fyerjes në kupti të nenit 10 nga KEDNJ.

○ Nuk është realizuar.

3

Revidim i rregullave procedurale me qëllim që të mos kyçen raste të vogla dhe në vend të kësaj të zmadhohet përdorimi i mediacionit për zgjidhje të tyre.

○ Këshilli i Etikës gjatë muajit mars e publikoi analizën vjetore për ndryshime në kornizën ligjore dhe në vetë-rregullimin e mediave në Maqedoni për vitin 2016 në të cilën u përfshi edhe ndërmjetësimi si rekomandim për përmirësimin e gjendjeve me mediat.

2

Përkrahje dhe promovim më i madh i përdorimit të vetërregullacionit si alternativë e veprimit gjyqtar.

○ Organizata të pavarura mediatike dhe Këshilli i Etikës janë aktivë në këtë plan dhe kanë dhënë rekomandime për përmirësimin e akteve normative mediatike dhe vetë-rregullimin në fushën e mediave, të cilat deri më tani nuk janë zbatuar.

2

Garantimi dhe shqyrtimi në nivel politik i praktikimit të vetëkufizimit të përshtatshëm të politikanëve dhe funksionarëve publik që të mos fillohet procedurë për shpifje në përputhje me parimet e GJENJ.

○ Në periudhën e kaluar më shumë u aktualizuan disa lloje të tjera të sulmeve ndaj gazetarëve, të cilët ishin cak edhe i ndërhyrjes në Kuvend më 27 prill të vitit 2017.